

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ GS Construction” SH.P.K.**

Ne Tirane, sot me date **12.02.2024 (dymije e njetzet e kater)**, ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” me vullnetin tone te lire dhe te plote vendosem themelimin e shoqerise “ **GS Construction** ” **SH.P.K.** me kushtet si me poshte vijon:

**NENI 1**

Ortaku themelues i vetem i shoqerise eshte:

**GAZMEND SEJDIA**, lindur ne Kukes me date 29.01.1976, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr. Leternjoftimi 035102361. me 100% te koutave te shoqerise.

**NENI 2**

**Emertimi**

Emertimi i plote i shoqerise eshte Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “ **GS Construction** ” **SH.P.K.**

**NENI 3**

**Selia**

Selia e perkohshme e Shoqerise “ **GS Construction**. do te jete ne Tirane, Rruga “ Grigor Gjirokastriti, pll 2, ap 4, Tirane  
Pervec ushtrimit te aktivitetit ne nivel qendror, shoqeria ka te drejte te hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashte vendit. Selia e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**NENI 4**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar, me perjashtim te rastit kur mbaron sipas parashikimeve te ligjit ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

**NENI 5**

**Objekti i veprimtarise**

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Punime betoni,
- armatura,
- muratura te ndryshme,
- suvatime,
- punime gipsi,
- patinime,
- bojatisje,
- punime elektrike,
- punime hidraulike,
- punime çatie,
- punime druri,
- skeleri,
- kondicionime-aspirime

#### **NENI 6**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 Leke. Ky kapital ndahet ne 1 kuote me vlere prej 10.000 leke e nenshkruar 100% nga ortaku. Ky eshte kapitali efektiv qe nga regjistrimi i shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise ndahet ne kuota te zoteruara, si me poshte:

Emri Mbiemri	Perqindja %	Kuota (pjese)	Shuma e kapitalit
Gazmend Sejdia	100%	1	10.000

#### **NENI 7**

Administrator i vetem dhe i pare i shoqerise do te jete Gazmend Sejdia me mandat 5 vjeçar.

#### **NENI 8**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te Statutit dhe ketij Akti Themelimi.

#### **NENI 9**

#### **Dispozita e fundit**

Ky akt eshte perpiluar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.

**ORTAKU THEMELUES**

**Gazmend SEDJIA**



